

## ASPECTUALITY OBSERVATIONS ON THE VARIETY OF SHKODRA

**Gjilda Alimhilli Prendushi**

Albanian Language and Literature. University of Bari “Aldo Moro” Bari. Italy

E mail: gjilda.prendushi@uniba.it

### Abstract

In this paper, part of a wider study, we introduce and analyze some elements of aspect with its typical interactions with lexical verb classes in the Northern Gheg dialect compared to the Standard Albanian. It is important, in this context, that we do not group verbs, but rather meanings of verbs. The main criterion for the classification is the *temporal dynamics* expressed by the verbs in question, i.e. the probability according to which a given action or a particular state may change over time. In the specific case of the perfective aspect (aorist), the relationship between the *operator* and *operandum* consists in the action carried out with the presence, or less, of a result, or in the beginning of the action, or simply in the limited duration of verbal action. On the other hand, the imperfective (imperfect - synthetic and analytical forms) can be combined in principle with all verbs, but also in this case, with the typical effects according to their verbal action. Analysis of the grammatical aspect and lexical actionality in the variety of Shkodra, in this paper, is based on *Grammatica della Lingua Albanese* of G. J. Merturi (1904).

**Keywords:** *aspectuality, Gheg dialect, grammar, lexical-grammatical categori.*

## VËZHGIME MBI ASPEKTUALITETIN RRETH SË FOLMES SË SHKODRËS

### Abstrakt

Në këtë artikull, pjesë e një studimi më të gjerë, kemi paraqitur e analizuar ndërveprimin e disa elementeve të aspektit me klasat kryesore leksikore foljore në dialektin geg, të së folmes së Shkodrës, në krahasim me gjuhën shqipe standarde. Është e rëndësishme të theksojmë, në këtë kontekst, që ne nuk grupojmë folje, por kuptime të foljeve.

Kriteri kryesor për klasifikimin është *temporal dynamics* e shprehur nga foljet në fjalë, dmth mundësia sipas së cilës një veprim i caktuar ose një gjendje e caktuar mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Në rastin konkret të aspektit të kryer, marrëdhënia ndërmjet *operator*-it dhe *operandum*-it qëndron në veprimin e kryer që shpie në një rezultat apo jo, ose në fillimin e veprimit, ose thjesht në një kohëzgjatjeje të kufizuar të veprimit foljor. Nga ana tjetër, format e së pakryerës (sintetike dhe analitike) mund t'i përdorim në parim me të gjitha foljet, por edhe në këtë rast, me efekte karakteristike sipas veprimeve të tyre foljore.

Analiza e aspektit gramatikor dhe e kuptimeve leksikore foljore në të folmen e Shkodrës, në këtë punim, bazohet tek *Grammatica della Lingua Albanese* e G. J. Merturit (1904).

**Fjalë kyçe:** *aspektualitet, dialekti gegë, gramatikë, kategori leksiko-gramatikore.*

## 1. Parashtrim teorik

Kur flasim për aspektualitetin, është e nevojshme të bëhet dallimi mes komponentëve leksikorë dhe gramatikorë që në tërësinë e tyre përbëjnë kuptimin aspektual të një thënieje. Duke qenë se si komponentët leksikorë ashtu edhe ata gramatikorë kanë karakter semantik, kuptimi aspektor i përgjithshëm është rezultat i bashkëveprimit të tyre. Karakteristikat e një ndërveprimit të tillë mund të përshkruhen vetëm duke ndarë saktësisht dy komponentët.

Grupimi leksiko-semantik i foljeve ka të bëjë me studimin e mënyrës së paraqitjes prej tyre të rrjedhës së veprimit. Kështu, te mënyrat e veprimit bëhet fjalë për analizën dhe klasifikimin e kuptimeve leksikore të foljeve të ndryshme, të cilat si rregull i bashkojnë përkatësisht i veçojnë mjetet fjalëformuese. Edhe kur për shprehjen e mënyrave të ndryshme të veprimit përdoren ndërtime të veçanta sintaksore, prapëseprapë ato janë në funksion të kuptimeve leksikore përkatëse, prandaj nuk kanë të bëjnë me kuptime gramatikore, por me kuptime leksikore të këtyre ndërtimeve. Pra, hetohen kuptime që qëndrojnë në vetvete dhe që i bashkon jo kuptimi leksikor individual, por kuptimi leksikor i përgjithshëm. Ndërsa në rastin e aspektit kemi të bëjmë me kundërvënie gramatikore, të shprehura me mjete gramatikore, pra me forma të ndryshme të së njëjtës folje. Aspekti realizohet kryesisht nga zëvendësimi i kohëve të foljes, në të kundërt, mënyra e veprimit foljor nuk tregohet në përgjithësi nga zgjedhimi. Një përfundim i tillë është në thelb universal, në këtë punim do të përpiqemi të dëshmojmë se në ç' masë është i vlefshëm për variantin e shkodranishtes.

Komponenti leksikor i aspektualitetit nuk shprehet vetem nga folja. Në disa raste në gjuhën shqipe ka mjete karakteristike fjalëformuese për të shprehur mënyrat e ndryshme të veprimit foljor, ose ndërtime foljore të posaçme. Pikërisht, duke u bazuar në këta tregues, mund të themi se në gjuhën tonë mënyrat e veprimit foljor, megjithëse shprehin kuptime leksikore, në planin e shprehjes së tyre nuk janë një kategori e pastërt leksikore, por edhe fjalëformuese e sintaksore, pra, në këtë vështrim janë si të thuash një kategori deri diku leksiko-gramatikore. Për më tepër, për të ndihmuar për shprehjen e një kuptimi të caktuar, shpesh, ndihmojnë edhe tregues të ndryshëm leksikorë, që i përkasin kontekstit. Në realizimin e komponentit leksikor të aspektualitetit kontribuojnë edhe analizimi i shkallës së përputhjes ndërmjet çdo klase të dhënë foljore dhe një bashkësie të zgjedhur si, me rrethanorin e kohës (që karakterizon një veprim pa dhe me cak kohor) ashtu edhe me foljet aspektore (që në përbërje të togfjalëshave të caktuar, përdoren për të treguar fillimin, ndërprerjen, vazhdimin ose mbarimin e veprimit të emërtuar nga fjala ndjekëse). Me dobi është edhe shqyrtimi i raporteve mes mënyrave të veprimit e mënyrave dhe kohëve të foljes. Për probleme të veçanta edhe vëzhgimi i subjektit apo objektit në përbërje të frazave (Studimi i këtyre çështjeve dhe analizat semantiko-sintatiksore kanë bërë të mundur paraqitjen e veçorive të klasave foljore sipas mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe. Kjo temë trajtohet në mënyrë të plotë tek monografia Alimhilli Prendushi, 2009).

Pas këtij parashtrimit teorik, mund të trajtojmë argumentin e punimit: aspekti dhe mënyrat e veprimit në shkodranishte, sipas G. J. Merturit tek "Grammatica della lingua albanese" e 1904-s (Gaspere Jakova-Merturi, 1904: 84-134). Analiza që vijon, e disa komponentëve të aspektualitetit në këtë të folme, bazohet në të dhënat e paraqitura në këtë gramatikë.

## 2. Analizë e aspektualitetit të së folmes së Shkodrës

### 2.1. Kundërvënia aspektore mes së kryes së thjeshtë dhe së pakryerës

Në gjuhën shqipe kundërvënia morfologjike e kryer e thjeshtë / e pakryer e pacaktuar imperfektive karakterizohet nga lidhja në mes të realizimit të një veprimi foljor në raport me

mos realizimin e tij (Për një analizë të thelluar të sistemit foljor në gjuhën shqipe shih Dhrimo, 2008: 234-417 dhe rreth opozicionit perfekt/aorist Breu, 2008: 96-100). Kjo do të thotë që e kryera shërben për të treguar vetëm veprime të përfunduara, duke përfshirë të gjitha limitet e mundshme, ndërsa e pakryera kufizohet në shprehjen e veprimit pikërisht të papërfunduar a më mirë të themi thjesht në zhvillim e sipër në një çast të së shkuarës. Kundërvënia morfologjike aspektore, në gjuhën shqipe dhe në dialektet e saj, është e kufizuar në preterit (kohë e shkuar e foljes), ndërsa e tashmja, e ardhmja, e shkuara etj. nuk diferencohen nga pikëpamja aspektuale. Prandaj vetëm në preterit është e mundur që të realizohet ndërthurja aspektore në kundërvënien mes përshkrimit të situatës (e pakryera) dhe ndryshimit të situatës (e kryera). E kryera merr, si të themi, funksion krejtësisht kohor të një preteriti, ndryshe nga e pakryera e cila përmbledh në vetvete funksione aspektore e kohore. Këto funksione të së pakryerës në gjuhën shqipe paraqiten në veçoritë semantike, si: në distancimin kohor nga momenti i tashëm i të folurit; në durativitetin e veprimit apo të gjendjes; në të shprehurit e veprimit si të dëshmuar, e nganjëherë edhe të përjetuar nga folësi dhe në lokalizimin (jokalizimin) kohor. Nga veçoritë e dhëna semantike duhet dalluar veçoria e distancimit kohor dhe dëshmimi i veprimit apo gjendjes. Këto dy veçori semantike e pakryera e shqipes i shpreh në mënyrë konstante. Sa i përket veçorive semantike aspektore të durativitetit, dhe të veçorive aspektore-kohore të lokalizimit të veprimit në kohë, e pakryera e gjuhës shqipe mund t'i shprehë këto veçori, por jo në mënyrë konstante. Përveç kësaj, të shprehurit e veçorive të dhëna semantike varet nga kushtet konkrete gjuhësore, në të cilat realizohet trajta e dhënë e së pakryerës, e në disa raste edhe nga kuptimi leksikor i foljes konkrete, nga e cila formohet trajta e dhënë (Shih edhe Sadiku, 1975: 55).

#### Tek *Grammatica* e Merturit:

a. Foljet e të gjitha zgjedhimeve në formën veprorë në të pakryerën marrin mbaresat: *-shè/-/tè/-(i)shim/-(i)shi/-(i)shin*, karakteristike të të gjithë gegërishtes veriore. Vetëm në disa folje të parregullta veta e parë njëjës dëshmohet me mbaresën *-sh*, duke bjerrë ë fundore, si: *paesh, raesh* etj. Ndërsa në formën joveprorë kemi paravendosjen e pjesëzës me burim përemëror *u* të foljes në zgjedhimin vepror.

b. Në të kryerën e thjeshtë foljet e të gjitha zgjedhimeve paraqiten ndërtuar me këto mbaresa: *-a/-e/-i/-mè/-et/-en*, pra me forma gramatikore të mbarë shqipes. Forma joveprorë e kësaj kohe jepet e ndërtuar nga pjesëza *u*.

Veç formave sintetike këtu gjejmë edhe trajta analitike të formuara nga paravënien formës së pashtjelluar përcjellore të foljes themelore të formave vetore:

c. të së pakryerës së dëftores të foljes ndihmëse *jam*, p.sh.: *ishè kahe maroshè (ishè kahe maròì), ishtë kahe lidhetè* etj.

d. të së kryerës së thjeshtë të dëftores të foljes ndihmëse *jam*, p.sh.: *kieech kahe hae, kieet kahe maroni*.

Në sistemin foljor, tek kjo gramatikë, gjejmë edhe një varg trajtash të tjera analitike. Këtu hyjnë trajtat që kanë përdorim më të thjeshtë, siç janë:

f. e kryera *kam marue, kee gabue* etj. (G. M. passato prossimo).

g. më se e kryera *kishè lae, kishtë mëndue* etj. (G. M. passato remoto).

Por gjejmë edhe trajta të tjera të mbipërbëra, përdorimi i të cilave në gjuhën e sotme shqipe është shumë i kufizuar dhe kryesisht ka karakter dialektor, ndeshen më tepër në të folmet gege, e sidomos në të folmen e Shkodrës. Këto ndërtohen:

h. duke i paravendosur pjesores së foljes përkatësisht format e së kryerës të foljes ndihmëse *kam: kam pase blee, kae pase vanue* etj. (G. M. trapassato prossimo).

k. duke i paravendosur pjesores së foljes përkatësisht format e të më se të kryerës të foljes ndihmëse *kam: kishè pase lye, kishtë pase kiae* etj. (G. M. trapassato remoto)

Duhet vënë në dukje se, trajtat e mbipërbëra (h) e (k) kryejnë të njëjtat funksione semantike dhe shpesh kanë të njëjtat veçori funksionale-semantike (përveç parakohësisë së tejshkuar) sikurse ato tek (f) e (g).

Në paragrafin më sipër bëme një parashtrim shumë të shkurtër mbi disa forma foljore të këtij sistemi kohor paraqitur nga Merturi. Por ne do të ndalemi vetëm tek dy kohët: e kryer e thjeshtë dhe e pakryer, me qenë se në këtë punim do të merremi vetëm me këndvështrimin aspektor. Për sa themë na behet e qartë se, kuptimi leksikor parësor i një foljeje, i rëndësishëm nga ana aspektore, mund të ndryshojë sipas klasës aspektore së cilës i përket: p.sh. vendosja e mjetit gramatikor të së kryerës, bën që folja, si pasojë, të marrë një kuptim të veçantë nga ndërveprimi mes leksikut dhe gramatikës.

Natyra e këtij kuptimi aspektor varet nga karakteristika terminative e klasës që i takon. Në parim, kuptimi leksikor parësor i një foljeje mund të jetë krejtësisht i pakufizuar, mund të ketë një kufi fillim veprimi ashtu si edhe një fund. E rëndësishme në sjelljen aspektore të foljes është kryesisht të qenurit si dhe natyra e limitit terminal.

2.1.1. Foljet (Më tej, termi "folje" do të përdoret për "kuptim foljor") *me gnofte, me pae, me durue* etj. emërtojnë gjendje dhe ndryshime gjendjeje. Kjo veçori semantike i bën të grupohen në klasën e foljeve durative të quajtura stative, të cilat nuk kanë një strukturë kohore të brendshme. Kur përdoren në të pakryerën *gnifeshë (ovv. gniheshë), shifeshë (ovv. shiheshë), duroshë* gjendja e shprehur prej tyre paraqitet si e vlefshme për situatën e dhënë, pa marrë parasysh karakteristikën e saj terminative. Në të kundërt, kur përdoren në të kryerën e thjeshtë *gnofta, pava, durova* kufijtë e tyre terminativë të brendshëm realizohen detyrimisht; në këtë rast kemi vetëm një limit kohor fillimi, i cili është i vetmi që realizohet. *Njoha dikë, dallova dikë o diçka* shprehin një kufi përfundimi. Pikërisht, me foljet stative të paqëndrueshme që shprehin relativitetin e gjendjeve, gjen përdorim e kryera e thjeshtë. Ndërsa tek stativet e qëndrueshme veprimi foljor tek këto folje përbën një karakteristikë të subjektit, është, pra, veti e përhershme e tij. Në këtë kuptim, veprimi nuk ka kufij të prerë, që ia përcaktojnë zgjatjen në përfytyrimin e folësit apo shkruarit. Foljet, që shprehin kuptime të tilla, nuk paraqesin në të kryerën asnjë pikëfillim veprimi, por përdoret thjesht si kokë foljore. Prania e kësaj nënklase është pasqyruar nga foljet: *me ghiasue, me kene, me besue* etj.

2.1.2. Një klasë tjetër foljore përbëhet nga të ashtuquajturat vijimore, të cilat e paraqesin mënyrën e veprimit në proces, të pakufizuar në kohë, si tek: *me fole, me rhenue, me fiët, me barte (me baite)*. Nuk jepet asnjë e dhënë për fillimin e mbarimin e veprimit, por vetëm për zgjatjen e tij. Megjithëse, tek këto folje, realisht, përveç çastit të fillimit të veprimit kemi edhe atë të mbarimit në formën e një mundësie për përfundimin e procesit, meqenëse nuk mund të ketë një zgjatje të pakufizuar të tij. Gjithashtu, veprime të tilla mund të ndërpriten disa herë nga subjekti brenda së njëjtës ngjarje ose të njëjtit episod. Momenti, në të cilin përfundon ose ndërpritet veprimi, nuk është i përcaktuar nga vetë veprimi, por nga rrethana të jashtme, siç janë vullneti i folësit apo i bashkëbiseduesit. Kur një veprim i tillë shprehet në aurist *folat, rhenova, fieta, baita* përfundimi i mundshëm i tij (në shtesë të një pikënisje të detyruar) mund të realizohet vetëm si kufizim kohor. Pra del, siç mund të themi, një kuptim "kufizues". Në qoftë se këto veprime shprehin në të pakryerën *fliteshë, rhenoshë, fleeshë (fleishë), baishë (bajeshë)* veprimet jepen në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës, pa asnjë të dhënë për fillimin a mbarimin.

2.1.3. Klasat foljore aspektore të përshkruara deri tani, mund t'i përfshijmë tek joteliket. Atyre iu kundërvihen foljet telike, në të cilat përfundimi i veprimit është i pashmangëshëm, i lidhur ngusht me proceset që ato shprehin. Pikërisht, në shqipe, foljet rezultative e çastësore përbëjnë dy klasa të veçanta brenda këtij grupi.

Kjo e fundit është klasa e proceseve jodurative, foljet: *me pree, me vrae, me vetue* tregojnë një veprim të papritur, shumë të shpejtë në çastin e përfundimit të tij. Tek këto folje, me

kuptim plotësisht telik, fundi i procesit përcaktohet menjëherë sapo ai fillon, pa asnjë mundësi ndërprerjeje të tij. Kështu, me foljet e kësaj klase nuk është e mundur të përftojme një të pakryer të lokalizuar në kohë, kjo do të thotë se një veprim i tillë mund t'i referohet një situatë të dhënë vetëm në kuptimin e një veprimi të përsëritur në vazhdimësi, apo kur ka lidhje me disa objekte veprimi: *preeshë (priteshë)*, *vritshë*; ndërsa në të kryerën e thjeshtë: *preva*, *vrava* vetëm pohon kufijtë leksikore të brendshëm që gjenden tek folja, kështu që, në vështrimin leksiko-gramatikor, përdorimi i saj është i tepërt. E kryera shpreh, nëpërmjet veprimit në fjalë, një ndryshim gjendjeje.

Në disa procese, të emëtuara nga folje të tilla, mund të dallojmë fazën fillimore (këtu kemi të bëjmë me mikrondryshime), ndërsa ngjan e vështirë sa dhe e pamundur të bëhet fjalë për fazën përfundimtare të saj. Kështu foljet *me chile*, *me ardhe*, *m'u binde* (mrekullohem), në të kundërt, pranojnë përdorimin e së pakryerës edhe me një veprim të vetëm (të lokalizuar në kohë). Kjo klasë foljesh në këtë kohë: *chileshe*, *vishë*, *bindeshe (u bindeshë)* shpreh një stad paraardhës ndaj ndryshimit të gjendjes (situatës). E kryera e thjeshtë: *chila*, *erdha*, *u binda* paraqet, nga ana tjetër, pasojen e këtij ndryshimi, karakterizon situatën e re nëpërmjet gjendjes që rezulton nga veprimi foljor në fjalë.

2.1.4. Foljet çastësore paraqesin pika të përbashkëta me një klasë tjetër foljesh telike, të cilat u takojnë durativeve. Këto të fundit karakterizohen nga procese që sjellin arritjen e një përfundimi ose rezultati të caktuar. Kështu tek *laeva* apo *bleeva diçka* foljet *me lae*, *me blee* në përbërje të këtyre sintagmave janë durative, rezultative. Shprehja e mirëfilltë e mënyrës rezultative të veprimit nga këto folje realizohet përmes mjeteve sintaksore dhe së kryerës, që ka përdorim të mirëfilltë kohor.

Format *laeshe*, *bleshe* nuk bëjnë fjalë për një veprim durativ rezultativ, por vijimor. Në kontekste të veçanta, rezultatet në të pakryerën shfaqin një ngjyrim të tipit konativ (pra, tregojnë përpjekjen për të kryer një veprim), ose e pakryera mund të përdoret në vend të së kryerës së thjeshtë për të shprehur veprimin që si i tillë ka marrë fund, kur rezultati i tij qëndron para folësit a shkruarit.

Kështu, foljet telike, në trajtat e së pakryerës, nuk përjashtojnë mundësinë e të shprehurit të veprimit si fakt të kryer dhe të përfunduar në mënyrë të plotë në një kohë të caktuar (konkrete) të së shkruarës.

Ajo çfarë kemi paraqitur deri tani, na çon në përfundimin se, aspekti foljor në shqyrtim nuk ndryshon në mënyrë thelbësore nga ai i gjuhës shqipe standarde. Sidoqoftë, atë çfarë sollëm këtu nuk është një kuadër i plotë, duhet të vjelim edhe të dhëna të tjera tekstore në lidhje me përdorimin e aspektit foljor në shkodrëneshtë.

## 2.2. Trajta perifrastike foljore

Ndryshime, në raport me shqipen standarde, ndeshen në përdorimin e perifrastike foljore, që përbëjnë një fushë me shumë interes në lidhje me aspektin. Vëmë re që, edhe në të folmen e Shkodrës, kemi përdorimin e perifrastike progresive që shprehin fazën e zgjatjes së një veprimi foljor, duke dhënë (kur i referohen së shkruarës) kuptimin e së pakryerës së veprimeve të lokalizuara në kohë.

Si format progressive në gjuhën letrare (Në gjuhën shqipe koha e tashme dhe e pakryer realizohen nëpërmjet: 1. formë e pacaktuar imperfetive (formë kohore-aspetore imperfetive), si: *punoj – punoja*. 2. formë e caktuar perfetive (formë kohore-aspektore perfetive) realizohet nga ndërtimet: a. pjesëza *po* + e tashme e pacaktuar imperfetive; pjesëza *po* + e pakryer e pacaktuar imperfetive. b. *jam* + përcjellore; *jam* në të pakryerën e pacaktuar imperfetive *isha* + përcjellore), edhe perifraza “*jam* + *kahe* + foljen në dëftore” nuk është e lidhur me të shkruarën. Nga pikëpamja aspektore ato i referohen veprimit në vijimësi, para arritjes së

përfundimit të tij, përmbajnë kuptimin e aspektit të pakryer, pra të jomomentalitetit. Kështu, janë të përputhshme plotësisht me foljet vijimore si: *ishë kahe laei, ishtë kahe kalzon, ishin kahe losin*, ndërsa foljet çastësore janë të papërdorshme me një ndërtim të tillë se, siç kemi thënë, emërtojnë procese jodurative.

Nga pikëpamja e aspektit, këto forma perifrastike, janë shumë të rëndësishme sepse, duke iu referuar fazës së veprimit në vijimësi përpara arritjes së përfundimit të tij, përmbajnë një pjesë domethënëse të kuptimit të aspektit të pakryer, pra nuk shprehen çastësi.

*Grammatica* ndiqet edhe nga pjesët në prozë, si *Dialoghi, Storia, Favole* (Jakova-Merturi, 1904: 139-168), ku vërejmë edhe një seri perifrash me karakter aspektor. Ato i takojnë, padyshim, fushës së aspektualitetit, duke qenë se përcaktojnë apo sqarojnë lidhjen mes veprimeve jashtë fushës kohore e shkakore. Pra, megjithëse kemi të bëjmë së paku me mënyra veprimi të realizuara me forma analitike, nuk përbëjnë gramema aspektore, siç del nga fakti që nuk i referohen drejtpërdrejt kufijve të ‘stato di fatto’. Funkzioni i tyre është që të përgatisin ndryshimin e situatës së shprehur nga folja që mbart kuptimin në perifrastikë. Aspektoret që bëjnë pjesë në këto ndërtime sillen si ‘treguese’, përdorimi i të cilave është i lidhur nga kuptimi leksikor i foljes së dytë. Kështu, foljet jotekike dalin shpesh në ndërtimet: *filluen më pie, rhitë tuej prite, jam nise më bae*. Ndërsa foljet telike në ndërtimet, p.sh: *marova s shkrumit*.

Po këtu, nuk mund të lëmë pa përmendur, perifrastat me karakter modal, si p.sh. ato: “*mé dashtë*”; *a do mé ndeje, kee dashtë mé luite, s’dotë mé i-a kethye* apo ato “*mé muite*” *mundësh mé e lane, s’muishë mé prite*. E mbi të gjitha, perifrastat shkakore shumë interesante: *e kam bâ m’u chue, i ka vue mé fiët* etj.

Për këto ndërtime dhe të tjera është e nevojshme një analizë e kujdesshme tekstore, aq më tepër, kur del qartë që kategoria gramatikore (morfo-sintaksore) e aspektit realizohet edhe nëpërmjet perifrastave të sipërpërmendura.

### 3. Përfundime

G. J. Merkuri, tek *Grammatica della Lingua Albanese*, paraqet ndarjen në mes të së tashmes, së pakryerës e së kryerës së thjeshtë joperifrastike dhe një të tashmeje, një të pakryere e një të kryere të thjeshtë perifrastike. Tek trajta perifrastike “*jam + pjesëza kahe + forma e dëftores*” dy nga përbërësit e kësaj forme të veçantë janë të shtjellueshme, por duhet theksuar se ata nuk shtjellohen barabar si njeri dhe tjetri. Folja *jam* shtjellohet nëpër veta dhe kohë, përkatësisht në të tashmen, të pakryerën e të kryerën e thjeshtë, ndihmësja ndiqet nga pjesëza *kahe* dhe nga forma e foljes që mbart kuptimin e këtij togu, e cila shtjellohet vetëm në vetat dhe qëndron gjithmonë në kohën e tashme, si: *jam kahe maroi, ishë kahe maroi, kieech kahe maroi* etj.

Kjo trajtë perifrastike, tek *Grammatica*, është dhënë në brendësi të paradigmës së zgjedhimit, gjë që na duket me vend në përputhje me shkallën e gramatikalizimit të saj.

E folmja e Shkodrës paraqet, në kundërvënien aspektore në mes të së pakryerës dhe së kryerës së thjeshtë, një seri trajtash perifrastike foljore që i referohen fazave të veprimit foljor, në mënyrë të veçantë fazës vijimore të procesit, dhe prandaj mund t’i atribuohen fushës së aspektit.

Rrethanat e veçanta të përdorimit të të gjitha trajtave perifrastike, që janë pjesë e kategorisë semantiko-funksionale të aspektualitetit, në të ardhmen duhen hulumtuar në mënyrë më të detajuar në bazë të analizave tekstore.

## Bibliografia

- Alimhilli, Gj. (2001), L'Aktionsart nella lingua albanese - L'azione verbale continuativa e stativa, *Studi Italiani di Linguistica Teorica ed Applicata* XXX/2, PACINI editore, 371-395.
- Alimhilli, Gj. (2001), L'Aktionsart nella lingua albanese - L'azione verbale telica, *Studi Italiani di Linguistica Teorica ed Applicata* XXX/1, PACINI editore, 115-142.
- Alimhilli, Gj. (2008), Foljet aspektore dhe mënyrat e veprimt në gjuhën shqipe, *Omaggio a Girolamo De Rada - Atti del 5° Seminario Internazionale di Studi Italo-Albanesi e altri contributi albanologici*, Università della Calabria, Cosenza: T&P Editoriale, vol. 7: 1-13.
- Alimhilli Prendushi, Gj. (2009), *L'Aktionsart nella lingua albanese* Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimt në gjuhën shqipe, Falco Editore.
- Alimhilli Prendushi, Gj. (2013), Nuovi sviluppi sull'azione verbale nella lingua albanese, *Konferenca shkencore ndërkombëtare "Komunikimi ndëretnik në Ballkan"*, Universiteti i Tiranës –Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, 161-169.
- Breu, W. (2008), Aspetto verbale ed aspettualità nel dialetto italo-albanese di San Costantino Albanese, *Omaggio a Girolamo De Rada – Atti del V Seminario Internazionale di Studi Italo-Albanesi*, 93-112.
- Breu, W. (2009), Verbale Kategorien: Aspekt und Aktionsart. In: Kempgen, Sebastian, Kosta, Peter, Berger, Gutschmidt, Karl (Hrsg.), *Die slavischen Sprachen / The Slavic Languages*, Teilband 1 (HSK 32.1). Berlin, New York: Mouton de Gruyter, 209-225.
- Croft, W. (2012), *Verbs: Aspects causal structure*, Oxford: Oxford University Press, 31-69, 127-171.
- Dharmo, A. (1986), Paralelizma kuptimorë ndërmjet trajtave foljore me po (po punoj) dhe jam + përcjellore (jam duke punuar), *Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, 415-428.
- Dharmo, A. (2008), Çështje të sistemit foljor, *Për shqipen dhe shqiptarët*, Vëllimi I, INFBOTUES, Tiranë, 234-417.
- Gjinari, J. & Shkurtaj, Gj. (2003), *Dialektologji*, Shtypshkronja "Perlat Voshtina", Tiranë, 221-244.
- Jakova-Merturi, G. (1904), *Grammatica della Lingua Albanese*, FRASCATI.
- Sadiku, Z. (1975), Funksionet semantike kohore, aspektore dhe modale të imperfektit të gjuhës shqipe, *Gjurmime Albanologjike* IV-1974, 55-80.
- Sadiku, Z. (1976), Rreth opozicionit perfekt/aorist në gjuhën shqipe, *Gjurmime Albanologjike* V-1975, 51-59.
- Sadiku, Z. (1978), Funksionet semantike kohore-aspektore të aoristit të gjuhës shqipe, *Gjurmime Albanologjike* VII-1977, 257-278.
- Sadiku, Z. (1978), Funksionet semantike të trajtave pluskuamperfektore të gjuhës shqipe, *Gjurmime Albanologjike* VI-1976, 47-70.
- Sadiku, Z. (1979), Mbi sinoniminë e kohëve të shkuara të shqipes, *Gjurmime Albanologjike* VIII-1978, 137-145.